

IX

MBLEDHJA E KUVENDIT MBAJTUR ME 4.7.2002

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Parlamenti i Kosovës për më pak se 7 muaj pësoi dy humbje të mëdha, humbjen e dy deputetëve, Dje ka ndërruar jetë deputeti i Parlamentit të Kosovës z. Bedrush Çallaku. Është një humbje për tërë Kosovën për familjen dhe Parlamentin në veçanti. Prandaj e nderuara familje Çollaku, të nderuar deputetë më lejoni që t'ju ftoj me një minutë heshtje t'i bëjmë nderime z.Çallaku.

Një minutë heshtje,

Për rrugën jetësore, veprën e madhe, për realizimin e të drejtës së një populli, të familjes dhe individuale të tij do të na thotë një fjalë bashkudhëtari i një pjese të rugëtimit të deputetit të nderuar, z. Kosumi e të njejtën kohë do ta lexojnë telegramin e gjeneralit Agim Çekut që ia ka dërguar Parlamentit. Falën e ka z. Kosumi,

BAJRAM KOSUMI

E nderuara familje e Bedrush Çallakut, i nderuari kryetar i Parlamentit, të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës. Para mbajtjes së seancës së sotme të Kuvendit të Kosovës, Kuvendi po mban mbledhje komemorative për vdekjen e deputetit të këtij Kuvendi, zotëri Bedrush Çollaku. Kolegu ynë, zotëro Çollaku, pas një sëmundje të rëndë vdiq dje në orët e herëshme të mëngjesit. Ne sot shprehim pikëllimin e madh për vdekjen e hershme të kolegut, patriotit, të mikut dhe njeriut i cili tërë jetën ia kushtoi një ideali, çlirimit të Kosovës. Bedrush Çallaku u lind më 1940 në Prizren, ai u lind në një familje hasiane, me traditë atdhetarie, e cila gjatë shekujve kurrë nuk iu nënshtrua pushtuesit osman, serb, e fashist. Kjo traditë e fortë patriotike, ishte djepi i krijimit të personalitetit të tij patriotik dhe politik. Ai gjatë jetës së tij do të ndjekë këtë rrugë, asnjëherë nuk do të pajtohet me pushtimin e Kosovës. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, ndërsa Fakultetin Ekonomik në Prishtinë. Në fillim të viteve 60-ta zhvillon aktivitet në grupet e fshehta patriotike. Në vitin 1964 arrestohet nga regjimi serb, dhe 5 vjet mbahet në burgun e Nishit. Pos këtij dënimi ai do të arrestohet edhe do të mbahet më shkurt në burg edhe 2 herë, një herë në vitin 1979 dhe herën tjetër në vitin 1981.

Pas viteve 90-të ai ishte njeri nga udhëheqësit e lartë të partisë parlamentare të Kosovës, pastaj ishte veprimtari i lëvizjes popullore të Kosovës i angazhuar për ta ndihmuar zgjerimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ndërsa pos luftës ishte njëri ndër udhëheqësit e lartë të lëvizjes popullore të Kosovës. Në zgjedhjet parlamentare të Kosovës 2001 ai zgjedhet deputet i këtij Kuvendi. Përveç dhembjes sonë për kolegun tonë të Kuvendit z. Çollaku, ne që kemi pasur rastin ta njohim më gjatë dhe më përë së afërmi, shprehim dhembjen për mikun, dhe për bashkëveprimtarin tonë të madh i cili edhe në çastet më të vështira të Kosovës kishte guximin, vullnetin dhe mirëkuptimin pothuajse atror për ne miqtë e tij më të rinjë. Në lëvizjen patriotike në Kosovë është një numër jo i vogël i njerëzve, në biografite e të cilëve nuk mund të ndahet, një datë, një vit apo një kohë të caktuar më esenciale nga pjesa tjetër jetësore. Nuk mund ta bësh këtë, sepse tërë jeta e tyre është një angazhim i pandërprerë, i pafund dhe i pa anë, është një lëvizje e pakufishme për krijimin të lirisë. Tek ta njerëz çdo çast, e çdo ditë dhe çdo kohë janë esenciale në krijimin e lirisë.

E tërë nga ana e tyre jetësore është një vrull lirie. Në mesin e këtyre krijuesve të lirisë është edhe Bedrush Çollaku. Ai bëri vepra të mëdha dhe të vogla për Kosovën, mbajti gjallë shpirtin e lirisë së Kosovës, mësoi nxënësit e Kosovës, punoi kudo nëpër Kosovë, mbajti burg për Kosovën, ndihmoi luftën e Kosovës, ndihmoi gjysmë – lirinë e Kosovës, me një fjalë bëri atë që mund ta bënte vetm ai njeri që ka vendosur të jetojë i lirë. Besoj fuqimisht se fakti që në institucionin ligjdhënës të Kosovës, në Kuvend po jipet lamtumira e fundit z. Bedrush Çollakut është një dëshmi e fortë se në Kosovë është krijuar një themel i sigurtë mbi të cilin ajo dhe populli i saj do ta zgjidhë njëherë e mirë fatin e saj të lirisë. Për këtë ka punuar mbi 40 vjet edhe deputeti i këtij Kuvendi zotëri Bedrush Çollaku., Prandaj ai edhe do të jetë pjesë e pandashme e lirisë së Kosovës. Lavdi jetës dhe veprës së tij.

Do ta lexoj edhe telegramin që ka dërguar gjenerali lejtnant Agim Çeku, komandant i TMK-së.